



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:006098

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05843748

2023:022972

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mimoza Shabani dhe praktikanten Elmedina Hakiu në cilësi të procesmbajtëses, në çështjen penale kundër të pandehurit B.B me vendbanim në Ferizaj rruga “...” Banesat e ... hyrja nr., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar: PP/II.nr. 1953/22 e datës 25 Janar 2024, duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit: Nr..../24 e datës 20 Qershor 2024, në mes të pandehurit B.B, në njërën anë dhe të dëmtuarit N.F në anën tjetër, në bazë të nenit 357 par. 1 nënpar. 1.3 të KPP-së (Kodi me numër 08/L-032), si dhe nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datë 21 Qershor 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- **APROVOHET**, marrëveshja ndërmjetësimit me nr. .../24 e datës 20 Qershor 2024, mes të pandehurit B.B, në njërën anë dhe të dëmtuarit N.F në anën tjetër, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj.
- **HUDHET**, Aktakuza Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar: PP/II.nr.1953/22 e datës 25 Janar 2023, dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurit B.B i lindur me datë, nga i ati B... e ëma H... e gjinisë A..., me vendbanim në Ferizaj rruga “...” Banesat e hyrja nr..., me numër personal, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 15 par.1 nënpar.1.4 të KPRK-ës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese në çështjen penale kundër të pandehurit B.B me vendbanim në Ferizaj rruga “....” Banesat e....hyrja nr..., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar: PP/II.nr. 1953/22 e datës 25 Janar 2024, duke vepruar në këtë çështje penale në bazë të nenit 240 par.1 dhe par. 6 të KPP-ës, ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 12 Qershor 2024, në prezencën e prokurorit të shteti, të dëmtuarit si dhe të pandehurit.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, duke vepruar në këtë çështje penale dhe me pajtimin e palëve në procedurë dhe në bazë të nenit 229 par.1 të KPP-ës dhe nenit 8 par.1 dhe par.2 dhe nenit 14 par.1 dhe par.2 të Ligjit për Ndërmjetësim, vendosi që lënda penale të dërgohet në Qendër për Ndërmjetësim, ndërsa me datën 20 Qershor 2024, nga Qendra e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja me nr.../24 e datës 20 Qershor 2024, në mes palëve në procedurë respektivisht të pandehurit në njëren anë dhe të dëmtuarit në anën tjetër.

Pala e dëmtuar heqë dorë nga ndjekja penale dhe kompensimi i dëmit ndaj të pandehurit, duke na njoftuar se më nga ky rast nuk kanë pasur mosmarrëveshje mes vete, i pandehuri i ka kërkuar falje për këtë rast.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim, vlerëson se palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje penale sipas aktakuzës së evidentuar si: PP/II.nr. 1953/22 e datës 25 Janar 2024, për veprën penale që e ngarkon të pandehurin të zgjidhet me ndërmjetësim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësimit, andaj vendosi që ta aprovoj marrëveshjen si të bazuar.

Në bazë të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim, marrëveshja e ndërmjetësimit në datën e aprovimit nga gjykata përkatësisht nga data 20 Qershor 2024 do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Nga sa u tha më lartë, në bazë të nenit 357 par. 1 pika 1.3 të KPP-ës, si dhe nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i Përgjithshëm Penal,

2023:022972 e datës 21 Qershor 2024

Praktikante,

Elmedina Hakiu

Gjyqtarja,

Mimoza SHABANI

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës, në afat prej 5/pesë/ ditëve, nga dita e parë vijuese pas pranimi të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.